

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Kamenicës z. Shaip Surdulli**

I nderuari z. Surdulli,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shprehur që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009 dhe 7 – 12 dhjetor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në dy debatet e juaja të mbajtura në "Jeta në Kosovë", ju keni premtuar:

- Krijimin e Komunës së Hogoshtit;
- Ndërtimin e sistemit të kanalizimit, ujësjellësit dhe meremetimin e shkollës në Hogosht;
- Vazhdimin e punimeve të filluara në asfaltimin e rrugës Hogosht – Poliçkë – Desivojcë;
- Asfaltimin e rrugës Hogosht – Kopërnice – lagja Xhaçkaj si dhe asfaltimin e rrugëve të tjera në këto lokacione;
- Rregullimin e infrastrukturës në fshatin Koretin;
- Zhvillimin e ekonomisë bujqësore dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik;
- Krijimin e vendeve të reja të punës;
- Mbështetjen për bizneset dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme, që gjenerojnë punësim dhe të ardhura për familjet;
- Qeverisje transparente dhe efikase;
- Përmirësimin e kushteve në arsim;
- Rregullimin e infrastrukturës në qytete dhe të gjitha vendbanimet e tjera;
- Mbështetjen e rasteve sociale;
- Përkrahjen e klubeve sportive ekzistuese dhe stimulimin e krijimit të klubeve të reja;
- Investimet në lagjen Malësia;
- Riasfaltimin e rrugës dhe rregullimin e trotuarit në lagjen Çamëri;
- Ndërtimin e urës dhe rrugës që lidh lagjen Çamëria me lagjen Malësia, që do të kushtojë rreth 220.000 euro;
- Përfundimin e palestrës sportive në vitin e parë të mandatit;
- Rishqyrtimin e të gjitha vendeve të punës, me qëllim të rregullimit të çështjes së administratës komunale;
- Kryerjen e projekteve të filluara si: ujësjellësi në qytet, në Koretin, në Shipashnicë të Epërme dhe në Kopërnice;
- Ndërtimin e një shkolle të re të mesme në Roganë.

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)